




Pranuar / Doretuar / Punlopno / Prodato / Received / Delivery	08.12.2022	2	viti / god / year
Organ / Nishta / Organ / Jednica / Org / Unit	No Prof / Br / Pr / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	7788/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.900/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave** i përbërë nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër Anr.900/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes postës elektronike E-maili: ankesa.kpmshck@rks-gov.net, kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike "*masë disiplinore-Vërejtje*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa numër A.nr.900/2022 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. ANULOHET** Vendimi me numër protokollit 29642 i datës 14.09.2022 i nxjerrë nga Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, i korrigjuar në pikën I me Vendimin me numër protokollit 29681 të datës 15.09.2022, për shqiptimin e masës disiplinore "*Vërejtje*".
- III. OBLIGOHET** Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Kamenicës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.





## Ar sy e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Komunë të Kamenicës, në vendin e punës "Zyrtar i Arkivit", në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, të cilit me datë 16.04.2022 Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, numër protokollit 29642 i korrigjuar me vendimin e datës 15.09.2022 me numër protokollit 29681, me dyshimin se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të përcaktuar në bazë të nenit 46 paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 14.09.2022 me nr. protokollit 29642, ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 13.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e regjistruar me numër A.nr.589/20221, përmes postës elektronike, me pretendimin ankimor se "Vërejtja" i është shqiptuar pa bazë ligjore dhe pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, duke propozuar që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 14.09.2022 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 28.10.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, dhe kërkesën për prova shtesë . Me datë 09.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës dhe të datës 23 dhe 24.11.2022, përmes emailit zyrtar.

Me datë 24.11.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr. 169/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës Anr.900/2022 me numër të protokollit 6137/2022 të datës 13.10.2022, për ankuesin [redacted]

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesë Anr.900/2022 me numër protokollit 6137/2022 të datës 13.10.2022, e parashtrua përmes E-mail të datës 13.10.2022, ankesa.kpmsheck@rks-gov.net, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi -Vërejtja me shkrim me numër protokollit 29642 i datës 14.09.2022 e nxjerrë nga Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës; Vendim i datës 15.09.2022 me numër 29681, për korrigjim të vendimit të datës 14.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 09.11.2022 nga Njësia e personelit të Komunës së Kamenicës, me nr. protokollit 6936/2022, lidhur me ankesën e ankuesit; Akt emërim i datës 15.09.2011 me nr. protokollit 575/188 për ankuesin; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.12.2019; Dëshmi nga libri i dorëzimit të vendimit të datës 14.09.2022 për ankuesin; E-mail i datës 07.11.2022 përgjigje me shkrim lidhur me ankesën e Zyrtarit [redacted] nga znj. [redacted] Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, drejtuar tek znj. [redacted] dhe z. [redacted] dhe z. [redacted] E-mail i datës 23.11.2022 për prova shtesë, përgjigje e datës 24.11.2022 përmes emailit zyrtar të njësies së personelit të Komunës së Kamenicës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, ndaj ankuesit [redacted] i cili mbanë pozitën : "Zyrtar i Arkivit", në Drejtorinë për Kultur, Rini dhe Sport, në Sektorin e



Kulturës në Komunë të Kamenicës ,me datë 14.09.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje",me dyshimin se i njëjti ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës duke mos respektuar orarin e punës,nga se me datë 13.09.2022 pasi që është vizituar në vendin e punës në ora 15:00 nga Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës i njëjti nuk ka qenë prezent në vend të punës për të cilën mungesë nuk kishte leje apo për ndonjë arsye tjetër,dhe për mos prezencën e tij në vendin e punës, i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje" bazuar në nenin 46 paragrafin 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore "Vërejtje", me datë 14.09.2022 nga Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, me numër protokolli 29642,përmban shkelje të dispozitave procedurale duke pretenduar se vendimi nuk përmban arsyetim dhe fakte konkrete dhe është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, që ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet "Vërejtja" e datës 14.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sa i përket kësaj çështje ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë "* dhe në këtë kuptim kolegji konstaton se vendimi i Drejtoreshës për DKRS në Komunën e Kamenicës për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje",bie ndeshë edhe me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1.Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", e mbi këto baza ligjore të specifikuara më lartë konstatohet fakti se Drejtoresha e DKRS-së në Komunën e Kamenicës nuk është Mbikëqyrëse e Drejtpërdrejtë e ankuesit dhe mbi këto baza ligjore nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje".*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, administrimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi si më lartë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ngase nuk kishte kompetencë t'i shqiptojë masë ankuesit për shkak se e njëjta nuk është udhëheqëse apo Mbikëqyrëse e Drejtpërdrejtë e ankuesit, ashtu që Vendimi me numër protokolli 29642 i datës



14.09.222 i nxjerrë nga Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunë të Kamenicës, i korigjuar në piken I me Vendimin me numër protokollit 29681 të datës 15.09.222, poashtu është nxjerr në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase arsyetimi i të njëjtit ishte dukshëm i pamjaftueshëm apo i barabartë me mungesën e tij, andaj mbi bazën e konstatimeve të dhëna, konstatohet fakti se Vendimi i potencuar më lartë është vendim i paligjshëm siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", ndërsa kolegji konsideron të pabazuar arsyen se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka dalë në pension dhe ende nuk është regrutuar, nga se sipas kësaj përgjigje vetëm sa konfirmohet jo kompetenca e drejtoreshës së DKRS-së për shqiptimin e kësaj mase, ndërsa është obligim i organit punëdhënës për regrutim dhe sistemim konform dispozitave ligjore të pozitive që janë të lira dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.900/2022, datë 08/12/2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Kamenicës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

